

Albana Aliu, MA¹

UDC:

343.712.1:340.13(497.115)

**VËSHTRIM JURIDIKO-PENAL I VJEDHJEVE TË RËNDA,
BAZUAR NË LEGJISLACIONIN PENAL TË KOSOVËS**

**КРИВИЧНО ПРАВЕН ОСВРТ НА ТЕШКИТЕ КРАЖБИ ВО
КРИВИЧНОТО ЗАКОНОДАВСТВО НА КОСОВО**

**JUDICIAL OBSERVATION OF ROBBERY BASED ON KOSOVO
PENAL LEGISLATION**

Abstract:

Every society, having a proper legal structure and civic order, has the obligation to study the negative occurrences that threaten order and tranquility, in order to make a real assessment of their situation. Here begins the importance and need of this study. Because the rise of negative occurrences in society, as well as the rise of criminal offenses of “robbery” threatens citizens themselves, their security, their property, and at the same time lose their credibility in state or state institutions so-called judiciary bodies.

Taken into consideration that our country has moved to a social, economic and political orientation, as well as to the changes that have been made to the criminal legislation, it is evident that the commission of the criminal act “robbery” has been a widespread phenomenon since year to year suffered some slight oscillations, but always as a phenomenon was present although the prohibition. Different factors, such as: high-level unemployment, lack of awareness, poor educational background, poor economic conditions, etc., have been influenced in the performance of this phenomenon. For this reason, the sanctions

¹ Master of Penal Law, University of Pristina “Hasan Prishtina”, str. “Agim Ramadani” 10000, Prishtinë (albana.02@live.com)

foreseen for such criminal offenses are aimed at the rehabilitation and creation of living conditions through which the perpetrators of the offense are provided with rehabilitation and re-socialization, with the aim of raising the awareness of respecting the laws in force.

Keywords: Robbery, Penal Law, Criminal Offenses

Hyrje

Çdo shoqëri që posedon strukturë të mirëfilltë juridike dhe rend qytetar e ka obligim që t'i studiojë dukuritë negative që e kërcënojnë rendin dhe qetësinë, në mënyrë që ta bëjë vlerësimin real të gjendjes së tyre. Këtu fillon rëndësia dhe nevoja e këtij studimi. Sepse, rritja e dukurive negative në shoqëri e, po ashtu, edhe rritja e rasteve të veprës penale, “vjedhje e rëndë”, i kërcënon vetë qytetarët, sigurinë e tyre, pasurinë e tyre, e, të cilët, në të njëjtën kohë, humbin edhe besueshmërinë në institucionet e shtetit apo te të ashtuquajturat organe të judikaturës.

Duke e pasur parasysh se vendi ynë ka kaluar në një tanzicion shoqëror, ekonomik dhe politik, dhe ndryshimet që janë bërë në legjislacionin penal, vërehet qartë se kryerja e veprës penale, “vjedhje e rëndë”, ka qenë një dukuri mjaft e përhapur, që, nga viti në vit, ka pësuar disa lëkundje të vogla, por, gjithmonë, si dukuri, edhe pse e ndaluar, ishte e pranishme. Në kryerjen e kësaj vepre kanë ndikuar faktorët e ndryshëm, siç janë: papunësia në shkallë të madhe, mungesa e vetëdijesimit, përgatitja e ulët arsimore, kushtet e vështira ekonomike etj. Për këtë arsye, edhe sanksionet e parapara për veprat e tilla penale kanë për qëllim rehabilitimin dhe krijimin e kushteve jetësore, nëpërmjet të cilave, kryerësve të veprës penale, u mundësohet rehabilitim dhe risocializim, duke synuar rritjen e vetëdijes për t'i respektuar ligjet në fuqi.

1. Kuptimi dhe karakteristikat e veprës penale “vjedhja e rëndë”

Në trajtimin e kuptimit të veprës penale vjedhje e rëndë, në Kosovën e pasluftës, janë bërë disa ndryshime në legjislacionin penal, duke marrë parasysh edhe periudhën e tranzicionit nëpër të cilin ka kaluar vendi ynë, ku, menjëherë pas luftës, ka vazhduar aplikimi i ligjit

penal të ish-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës², i cili gjeti zbatim deri në vitin 2004, pastaj, fillon aplikimi i Kodit të Përkohshëm Penal, ndërsa, që nga 1 janari 2013, është në fuqi Kodi Penal i Republikës së Kosovës, ku edhe është paraparë vepra penale vjedhja e rëndë, në kuadrin e Kapitullit XXVII, për veprat penale kundër pasurisë³.

Si karakteristikë e veprës penale “vjedhje e rëndë”, duke u bazuar në nenin 327 të KPRK-së, është se kjo vepër penale ka lidhje të drejtpërdrejtë me vjedhjen e rëndomtë, pasi që vjedhja e rëndë realizohet në ato raste kur vjedhja e rëndomtë kryhet në rrethana të tilla kualifikuese, të cilat rrethana janë pikërisht ato që kanë lidhje me karakterin e vjedhjes së rëndë. Në dispozitat e nenit 327 të KPRK-së, janë përcaktuar katër grupe të rrethanave kualifikuese për shkak të të cilave vjedhja e rëndomtë konsiderohet vjedhje e rëndë.

Sipas legjislacionit tonë në fuqi, vjedhja e rëndë konsiderohet se ekziston kur vepra penale është kryer duke thyer, kaluar apo depërtuar me forcë në veturat e mbyllura, ndërtesat, dhomat, arkat, sandukët apo hapësirat tjera të mbyllura, ose duke i hequr pengesat e tjera, me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme⁴.

Mirëpo, është e rëndësishme të theksohet se në praktikën gjyqësore, si vjedhje e rëndë, disa autorë të së drejtës penale nënkuptojnë edhe depërtimin në hapësira të mbyllura, pa e dëmtuar substancën e objektit, siç është kalimi mbi mur.

2. Format dhe mënyrat e kryerjes

Si forma të kryerjes së kësaj vepre penale janë:

Kërcimi në veturë (kamion-tren) derisa ai është në lëvizje dhe hedhja e sendeve dhe prapë zbritja nga ai automjet-tren, hyrja në shtëpi,

² Ligji penal i ish-KSA të Kosovës në nenin 135 kishte paraparë veprën penale vjedhje e rëndë, Përmbledhje e Ligjeve Penale, Prishtinë, 1979, Instituti i kërkimeve juridike dhe shoqërore.

³ Kodi penal i Kosovës, neni 327.

⁴ Kryerësi ka vepruar në mënyrë posaçërisht të rrezikshme apo të vrazhdë, ka shfrytëzuar gjendjen e krijuar si pasojë e zjarrit, vërshimit, tërmetit apo fatkeqësive të tjera, ka shfrytëzuar paaftësinë ose gjendjen tjetër të rëndë të personit tjetër. (Po aty, neni 327, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1.,1.2.,1.3.,1.4.,).

banesë dhe vjedhja e pasurisë së luajtshme, kur personat nuk janë në shtëpi ose gjatë kohës sa ata janë në gjumë, hyrja në lokale të caktuara gjatë kohës kur është i hapur dhe fshehja në të, me qëllim që, kur të largohen të gjithë punëtorët, kryerësi, atëherë do ta kryejë veprën penale apo në raste kur kryerësi e thyen lokalin dhe hyn brenda për ta marrë pasurinë e luajtshme, pastaj atëherë kur vjedhja realizohet duke thyer me forcë ndërtesat e mbyllura ose duke hequr pengesat e tjera, me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme. Është e rëndësishme të theksohet se thyerja me forcë e hapësirave të mbyllura nënkupton hapjen, depërtimin, kapërcimin e pengesave dhe hyrjen me forcë në objektet e mbyllura apo në hapësira të mbyllura, pa vullnetin e pronarit apo poseduesit. Kjo është, p.sh., kur në një ndërtesë depërtohet brenda duke e thyer portën, duke e thyer dritaren, duke hapur ndonjë zgavër, duke e thyer drynin e valixhes, duke e hapur me forcë portën e arkës e të ngjashme. Po ashtu, si formë e kryerjes së veprës penale vjedhje e rëndë, duke u bazuar në praktikën gjyqësore dhe sipas disa autorëve të së drejtës penale, nënkupton depërtimin në hapësira të mbyllura pa e dëmtuar substancën e objektit, duke i kapërcyer pengesat, p.sh. hyrja nëpërmes ndonjë zgavre, kalim mbi mur etj. Andaj, me depërtim nënkuptohen të gjitha format e hyrjes së kundërligjshme në hapësirat e mbyllura, qoftë ato me përdorimin e forcës ose dëmtimit të pengesave, respektivisht, me kapërcimin e tyre me qëllim që në atë mënyrë të arrihet deri te pasuria e huaj, e luajtshme⁵.

Ndërsa, mënyrat më të shpeshta të kryerjes së kësaj vepre penale, janë: thyerja dhe depërtimi në ambientet e brendshme, përmes thyerjes së dritareve, xhamave, pastaj thyerja e bravave dhe drynave, dyerve, vitrinave, hapja e zgavrës në portën e hyrjes, dhomës etj. Por, edhe në hapjen e arkave me eksploziv apo me shufër të hekurt, hapja me çelësin origjinal, të marrë në mënyrë mashtruese, hyrja nga kulmi, duke i mënjeluar mbulesën, hyrja nga oxhaku. Mirëpo, kjo vepër penale mund të mbetet edhe në tentativë, atëherë kur bëhet hyrja në hapësira të mbyllura, mirëpo nuk përvetësohet asgjë nga pasuria e huaj, e luajtshme, po ashtu, si mënyrë më e vrazhdë e kryerjes së veprës penale, vjedhje e rëndë, në praktikën gjyqësore konsiderohet, si p.sh.: vjedhja e kryer duke kërcyer nëpër dritare të hapur, pragu i ulët i së cilës është për afër dy metra, vepra e kryer nga personi i cili paraqitet në cilësinë e personit zyrtar, i cili i kërkon dokumentet e identifikimit dhe nga ato ka

⁵ Salihu.I, Zhitija.H, Hasani.F, Komentari i Kodit Penal, Prishtinë, 2014, fq. 903.

nxjerrë dhe i ka ndalur të hollat, shkëputja e qafores së arit në vend publik, në prani të qytetarëve, shkëputja nga dora e kuletës, në prezencë të qytetarëve. Vepra penale e vjedhjes së rëndë, e kryer duke shfrytëzuar gjendjen e krijuar si rezultat i zjarrit, vërshimit, tërmetit apo fatkeqësive të tjera natyrore, si dhe vjedhja e rëndë e kryer duke shfrytëzuar paaftësinë ose gjendjen tjetër të rëndë, konsiderohet si mënyra më e rëndë e kryerjes së kësaj veprë penale.

Praktika gjyqësore na tregon se kryerësi, gjithmonë thyen ndonjë xham, i cili gjendet në pjesën prapa shtëpisë, pastaj, hapja e dritareve me shufër hekuri, edhe në këtë rast kryerësi mundohet të gjejë një pjesë mbrapa shtëpisë, në mënyrë që kryerja e veprës së tij të mos bjerë në sy të fqinjve, thyerja e portës, largimi i mbulojës së shtëpisë dhe hyrja nga çatia, ngjitja me litar përgjatë mureve të shtëpisë, me qëllim të gjetjes së një dritareje më të përshtatshme për t'u futur brenda, shfrytëzimin e pakujdesisë së personit, në rastet kur kryerësi merr çelësin origjinal të banesës apo të shtëpisë së tij dhe, në mungesë të tij, hyn brenda dhe vjedh pasurinë e tij të luajtshme.

3. Përgjegjësia Penale e Kryerësit

Në grupin e elementeve të veprës penale, po ashtu, bën pjesë edhe përgjegjësia penale, përkatësisht faji (fajësia), i cili element i shoqëron të gjitha veprat penale e, poashtu, edhe me rastin e kryerjes së vjedhjes së rëndë.

Pra, përgjegjësia penale është kusht që doemos duhet të plotësohet, për t'u konsideruar një vepër si vepër penale dhe për të pasur mundësi që kryerësit të saj t'i shqiptohet sanksioni penal.

Në teorinë e së drejtës penale, një person konsiderohet penalisht i përgjegjshëm, nëse në kohën e kryerjes së veprës penale personi në fjalë ka poseduar cilësi të caktuara psikike, si dhe nëse te ai kanë ekzistuar marrëdhëniet e caktuara psikike për veprën që e ka kryer.

Pra, në përgjegjësi penale mund të thirret vetëm personi i cili në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm dhe i fajshëm.

Nga nocioni i këtillë, del qartë se përgjegjësia penale është vetëm element subjektiv apo psikik i veprës penale⁶.

Në fakt, ky është kuptimi i ngushtë i përgjegjësisë penale, sepse, në realitet, ekziston edhe kuptimi i gjerë apo objektiv-subjektiv i përgjegjësisë penale.

Pasi që vepra penale, doemos, përfshin elementet subjektive dhe objektive, sepse, gjithmonë, kur themi se një person ka kryer veprë penale, atëherë, nga kjo, nënkuptojmë se ai është penalisht i përgjegjëshëm. Përgjegjësia penale, si element subjektiv, është ndarë nga struktura e elementeve objektive vetëm për shkaqe praktike, përkatësisht, për analizimin më të lehtë e më të detalizuar dhe më adekuat.

Nocioni i përgjegjësisë penale, në kuptimin subjektiv, përputhet me nocionin e fajësisë, ngase përgjegjësia penale përfshinë përgjegjësinë dhe fajësinë⁷.

Në paragrafin e parë të nenit 17 të Kodit Penal është përcaktuar nocioni i përgjegjësisë penale.

Në të thuhet: “Kryerësi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia”⁸.

Vjedhja e rëndë është veprë e kundërligjshme penale, pasi që, me veprime të tilla, shkelen normat e ligjit penal, që e ndalojnë ndonjë veprim apo të ashtuquajturat normat prohibitive. Sikurse te veprat e tjera penale edhe te vepra penale vjedhje e rëndë vlen e njëjta, meqë sanksioni do të shqiptohet vetëm ndaj personit, i cili në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjëshëm dhe i fajshëm, pra ka qenë i vetëdijshëm dhe nuk i ka munguar elementi intelektual dhe volitiv për t’i kuptuar veprimet e tij. Me një fjalë, personi që e kryen

⁶ Salihu.I, E Drejta Penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2012, fq.266.

⁷ Një person konsiderohet i përgjegjëshëm atëherë kur posedon aso veti psikike që i bëjnë të mundshme të kuptojë rëndësinë e veprës penale dhe ti kontrollojë sjelljet e veta, ndërsa kryerësi i veprës penale konsiderohet i fajshëm atëherë kur ndaj veprës së kryer ka aso qëndrim apo raporti i cili e bën të mundshme t’i ngarkohet vepra, përkatësisht kur veprën e konsideron si të veten. (Shih: Salihu.I, vep.e.cit., fq.277).

⁸ Salihu. I, vep.e.cit., fq. 277.

veprën penale vjedhje e rëndë është i vetëdijshëm dhe vullneti i tij është i lidhur me veprën e kryer dhe pasojën e shkaktuar.

4. Sanksionet penale ndaj kryerësit

Çështje thelbësore e çdo shoqërie, e çdo shteti, është edhe përcaktimi i sanksioneve penale. Është e një rëndësie të veçantë që personi që kryen veprë penale të silltet para drejtësisë dhe ndaj tij të shqiptohet sanksioni penal në përputhje me të keqen e shkaktuar dhe në parandalimin apo pengimin e kryerjes së veprës penale në të ardhmen.

Në përgjithësi, masat të cilat janë të parapara në të drejtën penale dhe ndërmerren nga jurisprudenca penale ndaj kryerësit të veprës penale duhet të kenë të vetmin qëllim: mbrojtjen e çdo individi dhe të shoqërisë, në përgjithësi, nga kriminaliteti, si dukuri e rrezikshme, e dëmshme dhe e kundërligjshme. Mirëpo, në shtetet me kulturë dhe histori demokratike, në shtetet ku rrënjët i ka civilizimi bashkëkohor, dhe në ato vende ku të drejtat dhe liritë e qytetarit janë thelbësore, shtetet që mundohen ta çrrënjosin dhe parandalojnë kriminalitetin, krahas sanksioneve penale, duhet të disponojnë dhe të ndërmarrin masa të ndryshme, siç janë ngritja e nivelit të arsimit, kulturës dhe vetëdijes për respektimin e ligjit, të lirive dhe të drejtave, sigurisë dhe barazisë së qytetarëve në të gjitha fushat e jetës dhe një varg masash të tjera për mirëqenien ekonomike dhe sociale të qytetarëve dhe të shoqërisë të atij vendi, në tërësi.

Këto, në njëfarë mënyre, janë përcaktuar si masa të përgjithshme, pasi që po të njëjtat janë një mjet mjaft efikas në parandalimin e kriminalitetit dhe kryerjes së veprave penale, sidomos të atyre që janë në rritje, siç janë edhe veprat penale kundër pasurisë e në mesin e tyre, edhe vepra penale “vjedhja e rëndë”.

Mirëpo, sado që shteti mundohet, me masa të ndryshme, të ndikojë në ngritjen e vetëdijes të qytetarët, pastaj financimi dhe organizimi i programeve të ndryshme, me qëllim që t’u bëhet me dije se veprat penale janë të ndaluara me ligj, masat e ndryshme sociale, ekonomike, arsimore, prapëprapë shteti e ka parë të nevojshëm edhe zbatimin dhe aplikimin e sanksioneve penale. Sanksionet penale kanë për qëllim që t’i sigurojnë kushtet elementare të jetës së përbashkët⁹.

⁹ Arbitrariteti, deformimet si dhe shkelja e lirive dhe të drejtave të njeriut në lëmin e sanksioneve penale, shkaktojnë pasoja shumë të rënda dhe në të shumtën e rasteve dhe në pjesën më të madhe janë të papërmirësueshme. (Shih: Salihu.I, vep.e.cit., fq.414).

Por, ekzistojnë raste kur në shtetet të cilat akoma nuk e kanë arritur një shkallë të lartë të demokratizimit, aty sanksionet penale kanë qëllim tjetër, pasi që ato u shërbejnë interesave të ngushta burokratike apo partive të ndryshme dhe gjykata apo sistemi i drejtësisë bëhet vegël dhe u nënshtrohet gjykimeve arbitrare, deformimeve, pastaj, cenimit të sigurisë, por edhe të drejtave dhe lirive të njeriut, të cilat janë të mbrojtura me Konventa Ndërkombëtare. Sanksionet janë çështje themelore të së drejtës penale dhe janë në epiqendër të studimit të saj.

Gjatë zhvillimit historik të së drejtës penale janë vënë re ndryshime të mëdha në fushën e sanksioneve penale, këto ndryshime u shprehën, sidomos, në gjysmën e dytë të shekullit XX, por që të gjitha këto ndryshime kanë pasur rol të madh në ndikimin e krijimit të një legjislacioni penal bashkëkohor.

Tendencat e shoqërive bashkëkohore në fushën e legjislacionit penal konsistojnë:

Në vënien e një raporti të ri të shoqërisë, në mënyrë që personi që ka kryer vepër penale të mos konsiderohet si armik i shoqërisë, por që me trajtimin e nevojshëm penalo-juridik të bërë nga shteti dhe shoqëria, ai, pas mbajtjes së dënimit, të kthehet si anëtar i barabartë dhe i dobishëm i shoqërisë, pastaj si mundësi e mirë dhe lehtësim është edhe shqiptimi i dënimeve alternative, siç janë dënimi me kusht, gjysmëliria dhe urdhri për punë në dobi të përgjithshme, sepse dënimet alternative, në brendinë e tyre, janë substitute apo zëvendësime të dënimit me burgim. Këto dënime alternative janë rezultat i një rrjedhe progresive në të drejtën penale bashkëkohore, pastaj në preventimin special në të drejtën penale, veçmas në formë të risocializimit, dobësimin e elementeve retributive.

Duke u mbështetur në tiparet dhe postulatet që duhet të përmbushen mund të përcaktohet edhe nocioni i përgjithshëm i sanksioneve penale. Sanksionet penale janë masa të dhunshme penalo-juridike, të cilat i shqipton gjykata, në procedurën e përcaktuar në ligj, ndaj kryerësit të veprës penale, me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë dhe individit nga kriminaliteti, ndërsa, konsistojnë në marrjen apo kufizimin e lirive dhe të drejtave të caktuara apo në tërheqjen e vërejtjes kryerësit, se do t'i merren apo kufizohen liritë apo të drejtat nëse sërish kryen vepër penale¹⁰.

¹⁰ Salihu. I, vep.e.cit., fq. 415.

Sanksionet penale kanë këto karakteristika:

Me anë të sanksioneve penale, shoqëria mbron nga kriminaliteti vlerat më të rëndësishme të individit dhe të bashkësisë shoqërore. Sanksionet penale, mund t'u shqiptohen vetëm kryerësve të veprave penale. Kryerësve të veprave penale mund t'u shqiptohet vetëm ai sanksion penal i cili është paraparë me ligj, në momentin e kryerjes së veprës penale (nulla poena sine lege).

Sanksionet penale mund t'i shqiptojë vetëm gjykata, në bazë të procedurës së përcaktuar me ligj, e cila përmban më së shumti garanci për aktgjykim të drejtë, rrjedhimisht gjyqtarët, si bartës të funksioneve të gjykimit, me arsimimin e tyre juridik dhe përvojën e duhur, janë më të kualifikuar për t'u shqiptuar sanksione penale kryerësve të veprave penale. Me anë të sanksioneve penale, kryerësve të veprave penale u merren apo u kufizohen liritë dhe të drejtat e tyre.

Ndërkaq, vepra penale “vjedhje e rëndë”, e cila, po ashtu, është e sanksionuar në Kodin Penal të Kosovës, në nenin 327, ndër të tjerash, thuhet: “kushdo që kryen vjedhje nga paragrafi 1. i nenit 325 të këtij Kodi ose paragrafi 1. i këtij neni dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet”¹¹.

Nëse e bëjmë sqarimin e këtyre modaliteteve, në paragrafin e pare, vjedhja e pasurisë e cila e tejkalon shumën e caktuar, kjo formë e vjedhjes së kualifikuar ka të bëjë, kryesisht me vlerën e pasurisë së luajtshme, të vjedhur, dhe, kodi i ynë penal, ka përcaktuar mbi 5000 euro, kuptohet se kjo shumë apo vlerë mund të rrjedhë nga një vjedhje, por kjo formë e kësaj veprave penale mund të ekzistojë edhe kur vlera e tërësishme e sendeve të vjedhura, me disa vjedhje në bashkim real apo një vepër të vazhduar, e kalon shumën prej 5.000 euro.

¹¹ Pasuria apo shërbimi i vjedhur ka vlerë mbi pesë mijë euro, shërben qëllime fetare ose është vjedhur nga ndërtesa fetare apo ndërtesa tjetër që shërben për mbajtjen e ceremonive fetare, ka vlerë kulturore, fetare apo historike; ka rëndësi të posaçme shkencore, teknike apo artistike, është pjesë e koleksionit publik, koleksionit privat të mbrojtur apo e ekspozitës publike; ose është monument natyral apo objekt i natyrës nën mbrojtje, pasuria është vjedhur nga varri, pasuria është ar, kryerësi ka pasur me vete armë apo mjet tjetër të rrezikshëm, kryerësi ka vepruar si anëtar i grupit. (Shih: Salihu. I, Zhitija. H, Hasani.F, vep. e. cit., fq. 905).

Si dhe vlera e pasurisë së vjedhur përcaktohet sipas vlerës së tregut, në kohën e kryerjes së veprës penale.

Pastaj, në nënparagrafin 2.2, ku flitet për pasurinë e vjedhur, e cila shërben për qëllime fetare, e vjedhur nga ndërtesa fetare, apo, nga ndërtesat ku mbahen ceremonitë fetare. Qëllimi i këtij inkriminimi ka të bëjë me faktin se shteti e ka paraparë të nevojshme dhe të arsyeshme që, me anë të dispozitave ligjore, të mbrohen objektet e kultit. Është e rëndësishme të theksohet në këtë rast se për t'u realizuar vepra penale e vjedhjes së rëndë në objektet fetare, mjafton që, së pari, të jetë kryer vjedhja nga neni 325 par. 1 i Kodit Penal të Kosovës.

Në nënparagrafin 2.3 të Kodit Penal të Kosovës, është përcaktuar vjedhja që bëhet në vendet që kanë vlerë kulturore, fetare apo pasuri me rëndësi të posaçme shkencore, artistike, historike, teknike apo që është pjesë e koleksionit publik, e koleksionit privat të mbrojtur apo e ekspozitës publike. Pos me ligje të brendshme, çështja e vlerave kulturore është, po ashtu, e mbrojtur edhe me Konventat ndërkombëtare.

Me këtë formë të përcaktimit të veprës penale “vjedhje e rëndë”, mbrohet i gjithë thesari kulturor: të gjitha sendet në muze, galeri, librari dhe institucionet tjera publike dhe private, nën mbrojtje, inventari i kishës apo i objekteve të tjera fetare dhe sendet, lëndet arkivore, shënimet, dokumentet, dorëshkrimet, filmat, zbulimet arkeologjike, pikturat artistike dhe dizajnet, sendet etnografike, librat e vjetër dhe të rrallë, letrat me vlerë, pullat postare, armët e vjetra dhe të trofeve, vlerat teknike etj. Vlera e këtyre sendeve nuk vlerësohet sipas çmimit të tregut, vlera e tyre është historike, fetare, shkencore, kulturore, teknike dhe ato vërtetohen sipas dispozitave përkatëse për ruajtjen, konservimin dhe përparimin e të mirave kulturore, historike, teknike dhe shkencore që këtij përkufizimi i jepet karakteri blanket¹².

Në paragrafin 2.4 është paraparë një lloj forme e posaçme e vjedhjes, ku kryerësi vjedh sendet e luajtshme, nga varri.

Në paragrafin 2.5, po ashtu, është paraparë lloj i posaçëm i vjedhjes, ku kryerësi i vjedh armën personit tjetër. Në këtë rast nuk mund të trajtohet si çdo lloj tjetër i vjedhjes, por kjo formë e vjedhjes merr karakteristikat e veprës së rëndë penale, sepse kryerësi i kësaj vepre nuk

¹² Salihu. I, Zhitija. H, Hasani. F, vep.e.cit., fq. 905.

përgjigjet edhe për veprën penale armëmbajtje pa leje, nga neni 374 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në bashkim real, në veprën në fjalë.

Në vazhdim, në nënparagrafin 2.6, është përshkruar, po ashtu, si formë e rëndë e veprës penale, sepse kryerësi i veprës penale të vjedhjes, vepron si anëtar i grupit. Pra, pikërisht, ky element, kjo rrethanë, e bën vjedhjen, që personi e kryen si anëtar i grupit, të konsiderohet si vjedhje e rëndë.

Vepra është shprehje e aktivitetit të grupit, më së paku prej tre personave, të cilët janë akorduar për kryerje të veprave penale përkohësisht ose më gjatë, me ç'rast, secili anëtar i grupit e jep kontributin e vet për kryerje të veprës penale dhe për këtë arsye vjedhja është e karakterit më të rëndë dhe më të rrezikshëm. Bërja roje gjatë kryerjes së këtyre veprave penale, sipas kësaj teorie, konsiderohet si ndihmë në kryerje të veprës penale, e jo si bashkëkryerje¹³.

Në nënparagrafin 2.7, ku përmendet fakti se personi i cili po tenton tashmë ta kryejë veprën penale, është i pajisur me ndonjë mjet tjetër, qoftë: revole, bombë, thikë, gaz helmues, sëpatë e kështu me radhë, shihet qartë se personi i cili po e kryen veprën penale të vjedhjes, është i gatshëm ta përdorë ndonjërin prej atyre mjeteve. Kjo tregon, edhe një herë, për shkallën e rrezikshmërisë dhe vendosmërisë për ta kryer veprën penale.

Pos çështjeve që janë rregulluar me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, rol mjaft të rëndësishëm luan edhe praktika gjyqësore, sepse, shpeshherë, jeta dhe zhvillimet shoqërore mund të jenë një hap përpara ligjeve në fuqi. Rast konkret, nga praktika gjyqësore, kemi atëherë kur bëhet hapja e paautorizuar e hapësirës së mbyllur si dhe hapja me çelësin e vërtetë deri te i cili kryerësi i veprës penale ka arritur në mënyrë të paautorizuar dhe e ka shfrytëzuar atë për ta kryer veprën penale të vjedhjes. Rasti i tillë është edhe atëherë kur i akuzuari e ka gjetur çelësin, të cilin i dëmtuari e ka fshehur në vend të caktuar dhe, kur me ndihmën e atij çelësi e ka hapur derën e banesës së të dëmtuarit dhe në atë banesë e ka kryer vjedhjen, e shumë e shumë raste të tjera që njeh praktika gjyqësore.

¹³ Salihu. I, Zhitija. H, Hasani. F, vep.e.cit., fq. 905.

Siç e pamë, objekt mbrojtës i këtyre veprave penale është pasuria private dhe shtetërore dhe pasuria shoqërore që u takon personave juridikë dhe e cila ende nuk është privatizuar.¹⁴

Conclusion:

Robbery as a kind of criminality is quite present in contemporary societies as well as in our country, even in the past, although in criminal legislation it was not regulated as “Robbery”, it nevertheless existed as a theft and was present in all socio-economic formations.

The societal and state responses have been different, depending on the state regulations and the culture of the various countries, but in almost all cases the reaction to the thieves has been harsh and have been associated with very serious bodily harm to the perpetrators of theft and in this case also robbery. These corporal punishments were almost similar in all the states of that time, but from the transition to one social system to the other, the reactions for the perpetrators of this criminal offense have changed, because in most European countries have begun proclaiming human rights and

freedoms, while the purpose of punishment or punitive politics to perpetrators of crime but also to perpetrators of robbery has changed.

Because the punishment is no longer at the very center of criminal law, but what is now being given special importance is the reintegration and re-socialization of the perpetrator after the condemnation has been imposed because in order to reach the punishment as well the person who has already served the penalty should be returned as citizens equal to others.

However, criminal legislation should not be left out, as it is a key point in combating criminality because through adequate legislation and with a higher and more professional enforceability by the judiciary bodies, more success can be initiated in prevention and punishment.

However, it does not mean that nowadays all states have adopted a contemporary criminal law, because in many Asian countries the severe reaction to the perpetrators of thefts and in this case of robbery continues to prevail, since these states are not interested in reintegration-re-socialization of delinquent people but are more concerned with

¹⁴ Salihu, I. E Drejta Penale (pjesa e posaçme), Prishtinë, 2014, fq. 463.

punishment in accordance with the evil done and often this punishment is many times higher than the evil caused.

The criminal offense of robbery is, by nature, a very dangerous criminal offense and precisely for this reason lawmakers have found it reasonable to increase the duration of punishment in the Penal Code compared to the Provisional Criminal Code.

Robbery today is considered to be a very serious criminal offense, which based on the study made we noticed that there have been some oscillations of cases of commission of this offense from year to year.

By the commission of this criminal offense the goods of the people who are in these cases damaged, their movable property is violated, and at the same time there is a great uncertainty among the citizens, as well as a series of social consequences and other consequences that affect the injured, but also the members of his family.

Due to such circumstances and reasons, efforts have always been made to combat and prevent such acts. But of course, at every stage of the society's development, the reaction to this type of criminality has not been the same, as gradually the ways, means and measures of fighting and preventing robbery have gradually changed.

Recensentë:

Prof. dr. Afrim Osmani

Prof. dr. Qebir Avziu

Literatura dhe Aktet Normative:

-Salihu, I., E drejta Penale (pjesa e përgjithshme), Prishtinë, 2012.

-Salihu, I., E drejta Penale (pjesa e posaçme), Prishtinë, 2014

-Salihu, I., Zhitia, H., Hasani, F., Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2014.

-Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Kodi Nr.04/L-123, 13 dhjetor 2012.

-Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr.04/L-082, 20 prill 2012.

-Kodi Penal i Përkohshëm i Kosovës, UNMIK/RREG/2003/25, 6 Prill 2004.

-Përmbledhje e ligjeve penale, Instituti i kërkimeve juridike dhe shoqërore, Prishtinë, 1979.